



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 08.04.2024

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Kryetari i Komunes, mori:

V E N D I M

1. Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projekt-propozimet e OJQ-ve që kontribuojnë në Promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas.
2. Për implementimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave me Nr.04/2017 si vijon:
 - 2.1 Për realizimin e mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve për projekt-propozimet për Promovimin e Barazisë Gjinore:
 - 2.2 Mjetet financiare për mbështetjen financiare tërhiqen nga kodi i subvencioneve Çështje Gjinore.
 - 2.3 Vlera totale e planifikuar për këtë thirrje publike është në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej 5,000€ nga fondi burimor 21 dhe nënprogrami 16502, në kuadër të Drejtorisë për Administratë.
 - 2.4 Shuma minimale e mbështetjes financiare është 500.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 1,500€.
3. Mjetet financiare të planifikuara në pikën 2, paragrafi 2.3 do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekt-propozimeve të Organizatave Jo-qeveritare sipas dokumentacionit valid për zbatimin e thirrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.
4. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është 15 ditë pune dhe fillon në ditën e publikimit të thirrjes publike.
5. Organizata Jo-qeveritare munde të aplikojnë në kuadër të kësaj thirrje me vetëm një(1)projektë. Periudha e zbatimit të projektit është gjashtë(6)muaj nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.
6. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim.

Dokumentacioni i kompletuar në zarfin e mbyllur gjithashtu në usb e cila duhet të jetë brenda zarfit duhet të dorëzohet në adresën e komunës rruga 'Tahir Zemaj' në Zyrën pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e komunës ose përmes postës. Çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrën elektronike në email-adresën lindita.dervisholli@rks-gov.net.

7. Vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve e bënë komisioni vlerësues, nëse i plotësojnë kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit një të vendimit.

8. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të Organizatave Jo-qeveritare.

9. Pasi të merret vendimi për financim për aplikuesin e suksesshëm që mund të përkrahet nga kategoria e subvencioneve, projekti i të cilit i plotëson kushtet e financimit, Kryetari i Komunes mbështetur ne rekomandimin e Komisionit Vlerësues merr vendim për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo-qeveritare, që merren me përkrahjen, fuqizimin dhe promovimin e barazisë gjinore.

10. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Administratë e Komunës së Fushë-Kosovës.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

1 x Kryetarit të Komunës

1 x Drejtorisë së FB

1 x Drejtorisë së Administratës

1 x Njesiti për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore

1 x Arkivit

